

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6549
E enjte, 3 mars 2022
çmimi 0.40 €

Kuvendi i Kosovës
shpenzoi 8 milionë euro
gjatë vitit 2021 | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) KA PUBLIKUAR RAPORTIN
MBI INTEGRITETIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE | FAQE 4-5

BESIMI I QYTETARËVE NË INSTITUCIONET E GJYKATAVE DHE PROKURORISË, NË RËNIE



Rezultatet e raportit të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) tregojnë se qytetarët e Kosovës i shohin institucionet e sigurisë më të besueshme me një nivel më të lartë besimi ndaj tyre krahasuar me institucionet e tjera publike në Kosovë siç janë institucionet e drejtësisë, të cilat qytetarët i perceptojnë si më pak të besueshme dhe më integritet të dobët. Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës mbesin institucionet publike më të besuara nga qytetarët

Krasniqi: Është
emergjente nevoja e
anëtarësimit të
Kosovës në Këshillin
e Evropës | FAQE 7



USHTARËT E RUSISË PO
PËRBALLEN ME REZISTENCË TË
ASHPËR NGA ATA TË UKRAINËS | FAQE 2

AKTUALE



KOSOVA THEMELON FONDIN E
SIGURISË | F. 3

ZEMAJ: PROBLEMET NË
SHËNDETËSI JANË TË MËDHA,
SIDOMOS NË QKUK | F. 7

NAFTËTARËT NUK PAJTOHEN ME
MARZHËN TREGTARE | F. 3

EKONOMI



AGRESIONI RUS NË UKRAINË PREK
EDHE TRUSTIN, 90 MILIONË EURO
HUMBJE | F. 8

KRYETARI I AKB-SË: KOSOVA DHE
SHQIPËRIA TË VEPROJNË SI TREG I
PËRBASHKËT | F. 8

SPORT



MË 6 PRILL ZGJEDHJET PËR
KRYETAR TË FFK-së | F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sulmet e Rosisë po përballen me rezistencë të ashpër nga forcat e Ukrainës

KIEV, 2 MARS - Lufta në mes të Rosisë dhe Ukrainës ka mbërritur në ditën e shtatë të saj. Bombardimet ruse mbi qytetet e Ukrainës kanë vazhduar edhe të mërkurën. Janë dëmtuar shumë ndërtesa në qytetin Kharkiv. Sulmet ruse po përballen me rezistencë të ashpër nga forcat ukrainase.

Në një paraqitje të mërkurën, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se rreth 6 000 ushtarë rusë janë vrarë në gjashtë ditët e para të agresionit të Moskës dhe se Kremlinin nuk do të jetë të gjendje ta pushtojë vendin e tij me bomba dhe sulme ajrore.

Në anën tjetër mijëra ukrainas kanë dalë vullnetarë për ta mbrojtur vendin e tyre dhe për ta luftuar pushtimin e Rosisë,

Disa ishin me uniformë ushtarake, ndërsa të tjerët mbanin rroba civile dhe çanta shpine. Shërbimi Shtetëror i Emergjencës në Ukrainë ka njoftuar se të paktën 2 000 civilë ukrainas janë vrarë deri më tani nga pushtimi rus. "Më shumë se 2 000 ukrainas vdiqën, pa llogaritur mbrojtësit tanë. Fëmijët, gratë dhe forcat tona mbrojtëse po humbasin jetën e tyre çdo orë", ka njoftuar shërbimi në një deklaratë.

Sipas shërbimit, disa infrastruktura transporti, shtëpi, spitale dhe kopshte janë shkatërruar nga forcat ruse gjatë shtatë ditëve të fundit.

Forcat e armatosura të Ukrainës kanë thënë se morali i ushtrisë ruse dhe vullneti për



ushtrisë ruse.

Forcat ruse kanë sulmuar me raketa të mërkurën Kharkivin, qytetin e dytë më të madh të Ukrainës. "Si rezultat i goditjes së raketave të armikut, ndërtesat administrative u shembën nga zjarret", kanë pohuar shërbimet rajonale të urgjencës. Të paktën katër persona janë vrarë dhe nëntë të tjerë janë plagosur, ndërkohë që dhjetë janë shpëtuar nga rrënojat.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka njoftuar se administrata e tij ka marrë vendim për ta mbyllur hapësirën ajrore të ShBA-së për të gjitha fluturimet ruse.

Veprimi pason masa të ngjashme, të ndërmarra nga vendet evropiane dhe Kanadaja, në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës.

Duke folur para Kongresit amerikan për gjendjen në vend, Bideni ka theksuar se ndalesa do ta izolojë edhe më shumë Rusinë dhe do ta rëndojë edhe më shumë ekonominë e saj. "Rubla ruse ka humbur 30 për qind të vlerës së saj", ka thënë Biden.

Perëndimi ka vendosur sanksione të ashpra kundër Rosisë për ndërhyrjen ushtarake në Ukrainë.


Sanksionet përfshijnë edhe përjashtimin e disa bankave ruse nga sistemi bankar global SWIFT. "Ekonomia e Rosisë po lëkundet dhe fajin e ka vetëm [presidenti rus, Vladimir] Putin", ka deklaruar Biden.

Kryeministri britanik, Boris Johnson, ka thënë se veprimet e presidentit rus Vladimir

Putin në Ukrainë do të konsiderohen si krime lufte. "Nga regjimi i Vladimir Putinit kemi parë përdorimin e municioneve që ata tashmë kanë hedhur mbi civilët e pafajshëm, sipas mendimit tim, tashmë cilësohen plotësisht si një krim lufte", ka thënë ai të mërkurën në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar. Johnsoni ka thënë se Putini e kishte "llogaritur keq" përgjigjen ukrainase.

Lavrovi: Do të ndodhë një Luftë e Tretë Botërore, nëse përdoren armë bërthamore

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka deklaruar të mërkurën se nëse do të ndodhte një Luftë e Tretë Botërore atëherë, sipas tij, do të përfshiheshin armët bërthamore dhe kjo do të ishte shkatërruese për botën. Lajmi u citua nga agjencia e lajmeve "RIA". Lavrov ka thënë se Rusia, e cila nisi atë që e quan një operacion special ushtarak kundër Ukrainës javën e kaluar, do të përballej me një "rrezik real" nëse Kievi do të fitonte armë bërthamore.



përfshirë punonjës të IT-së apo ndërtues. Për të qenë më të përgatitur, ata kanë vendosur të marrin pjesë në trajnimin bazë përpara se të nisen për betejë. Qendra e vullnetarëve në Lviv u mbush të mërkurën me ushtarë të rinj që ishin regjistruar për t'u bashkuar me njësitë e mbrojtjes territoriale.

të fituar, po bien me shpejtësi. Sipas forcave ukrainase, morali po bie për shkak të mbrojtjes së qëndrueshme të trupave ukrainase. Ushtria ruse është hasur me sfida si mungesa e logjistikës, e naftës dhe e ushqimit. Deri më tani raportohen të paktën 5 840 humbje jete në radhët e



Kosova themelon Fondin e Sigurisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 MARS - Qeveria e Kosovës ka themeluar Fondin e Sigurisë në të cilin qytetarë dhe donatorë të ndryshëm mund të kontribuojnë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky fond është themeluar bazuar në nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, "situatës aktuale dhe pas konsultimeve me partnerët

ndërkombëtarë". "Mjetet e mbledhura financiare synohet të përdoren në përputhje me strategjinë e sigurisë shtetërore të Republikës së Kosovës që pritet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Funksionimi i këtij fondi do të rregullohet me akte përkatëse procedurale dhe do të përdoret ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar nga qeveria", ka thënë Kurti.

Ndërkaq ministri i Mbrojtjes,

Armend Mehaj, ka thënë se qytetarët mund të kontribuojnë me mjete financiare dedikuar sigurisë së Kosovës. "Siguria jonë kurrë nuk ka nënkuptuar pasiguri për të tjerët. Përkundrazi, dje, sot dhe nesër, ishim, jemi e do të jemi siguri e mbrojtje për të gjithë, pa dallim", ka deklaruar Mehaj përmes një postimi në "Facebook", duke shtuar se në ditët në vijim do të bëhen të ditura detajet e tjera se si qytetarët do të mund të

kontribuojnë në këtë fond.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka njoftuar se Thesari i Kosovës ka hapur një llogari zyrtare bankare për pranimin e fondeve të cilat dedikohen për siguri - Fondi i Sigurisë. Siç thuhet nga kjo ministri, përmes këtij fondi mundësohet pranimi i donacioneve të mërgatës si dhe çdo qytetari që është i interesuar të kontribuojë.

Llogaria e Fondit të Sigurisë do

të jetë funksionale që nga 2 marsi.

Më t'u dhënë lajmi për themelimin e këtij fondi, biznesmenë dhe figura publike kanë premtuar mjete financiare. Buxheti që ka ndarë Qeveria e Kosovës për FSK-në më 2022 kap vlerën e mbi 100 milionë eurove. Që prej vitit 2018 FSK-ja është në proces të transformimit në ushtri. Ky proces është thënë se do të zgjasë dhjetë vjet.



Naftëtarët nuk pajtohen me marzhën tregtare

PRISHTINË, 2 MARS - Shoqata e Naftëtarëve të Kosovës nuk po pajtohet me vendimin e Qeverisë së Kosovës për caktimin e çmimeve shitëse maksimale tregtare me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës.

Qeveria e Kosovës më 2 shkurt, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve nga lëvizjet e mëdha të çmimeve dhe eliminimit të çrregullimeve në treg me naftë dhe derivate të naftës, ka caktuar marzhën tregtare.

Ky vendim përcakton që te shitësit me shumicë marzha më e lartë tregtare të jetë deri në 4 për qind të çmimit të shitjes, ndërkaq te shitësit me pakicë marzha më e lartë deri në 6 për qind.

Vendimi i qeverisë hyn në fuqi më 3 mars dhe do të jetë në fuqi deri më 31 maj 2022. Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë për

"Radion Evropa e Lirë" se ky vendim vë në rrezik mbijetesën e bizneseve në këtë sektor. "Vendimi i qeverisë nuk është adekuat, nuk është i përshtatshëm për bizneset. Një pikë karburanti nuk mund t'i mbijetojë krizës. Ne e kuptojmë se çfarë situatë ekonomike është në Kosovë. Çmimet e derivateve janë të larta për qytetarët, por kjo është duke ndodhur në tërë botën", ka thënë ai.

Berjani kërkon që së paku te shitësit me pakicë marzha tregtare të jetë më e lartë. "Nga 6 centë duhet të rritet në 12 centë, në të kundërtën bizneset në këtë sektor nuk mund të mbijetojnë", ka deklaruar Berjani.

Rritja e çmimeve të naftës dhe benzinës në Kosovë ka shënuar nivelin më të lartë në 20 vjetët e fundit.

Berjani ka bërë me dije se kompanitë që furnizojnë me naftë



në Kosovë, më 1 mars këtë derivat me shumicë e kanë blerë 1.33 euro për litër. "Brenda ditëve ky çmim do të rritet edhe më shumë", është shprehur Berjani.

Më 2 mars në Kosovë një litër naftë është shitur për 1.43 euro, ndërkaq benzina 1.44 euro. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës, po ashtu, obligohen të gjitha depozitat dhe

pikat e shitjes së naftës të mbajnë në çdo kohë në stoqe së paku 5 për qind të kapaciteteve të tyre deponuese për qëllime të rezervave emergjente.



QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) KA PUBLIKUAR RAPORTIN
MBI INTEGRITETIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Besimi i qytetarëve në institucionet e gjykatave dhe prokurorisë, në rënie

Rezultatet e raportit të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) tregojnë se qytetarët e Kosovës i shohin institucionet e sigurisë më të besueshme me një nivel më të lartë besimi ndaj tyre krahasuar me institucionet e tjera publike në Kosovë, siç janë institucionet e drejtësisë, të cilat qytetarët i perceptojnë si më pak të besueshme dhe me integritet të dobët. Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës mbesin institucionet publike më të besuara nga qytetarët

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 MARS - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka paraqitur rezultatet e raportit të parë në kuadër të Barometrit të Sigurisë të Ballkanit Perëndimor mbi integritetin e institucioneve publike.

Duke reflektuar opinionet dhe qëndrimet e qytetarëve, ky raport ofron bazën për projektimin e një qasjeje të qeverisjes dhe politikave me fokus te qytetari. Raporti përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë diskuton rezultatet e perceptimeve të publikut në Kosovë ndaj institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe institucioneve publike në nivelin qendror. Pjesa e dytë shqyrton perceptimin e qytetarëve në lidhje me

përhapjen e korrupsionit në institucionet publike. Pjesa e tretë fokusohet në perceptimet e qytetarëve lidhur me procesin e punësimit në administratën publike.

Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, presidenti i Kosovës dhe komunat janë institucionet publike më të besuara në Kosovë, ku mbi 50 për qind e të anketuarve deklaruan se u besojnë apo u besojnë plotësisht këtyre institucioneve. Këto pasohen nga Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë me 45 për qind të të anketuarve që ndajnë një mendim të tillë.

Nga ana tjetër, më pak se 40 për qind e të anketuarve deklaruan se u besojnë apo u besojnë plotësisht Gjykatave, Prokurorisë, Shërbimit Korrektues të Kosovës, Qeverisë

së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës.

Rezultatet e raportit tregojnë se qytetarët e Kosovës i shohin institucionet e sigurisë më të besueshme me një nivel më të lartë besimi ndaj tyre, krahasuar me institucionet e tjera publike në Kosovë, siç janë institucionet e drejtësisë, të cilat qytetarët i perceptojnë si më pak të besueshme dhe me integritet të dobët.

Besimi i qytetarëve në institucionet e gjykatave dhe prokurorisë në Kosovë është në rënie të vazhdueshme dhe kjo është shqetësuese.

Qytetarët kanë shkallë më të lartë besimi tek institucionet publike të nivelit qendror, veçanërisht në krahasim me vitin paraprak (2020), mirëpo skepticizmi ndaj këtyre institucioneve mbizotëron në përgjithësi.

Perceptimi i qytetarëve për praninë e korrupsionit në institucionet publike përkon me perceptimin e tyre për besimin tek institucionet. Sa më i ulët të jetë besimi ndaj një institucioni, aq më i lartë është perceptimi se korrupsioni është i pranishëm në institucionin përkatës. Në përputhje me këtë, institucionet e sigurisë perceptohen të jenë më pak të korruptuara në krahasim me institucionet e tjera.

Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës perceptohen të jenë institucionet më pak të korruptuara me më pak se 25 për qind të të anketuarve që deklarojnë se këto dy institucione janë të korruptuara apo shumë të korruptuara, pasuar nga komunat me 33 për qind të të anketuarve që ndajnë mendimin se komunat janë të korruptuara.

Nga ana tjetër, më shumë se 45 për qind e të anketuarve e perceptojnë Qeverinë e Kosovës, Gjykatat dhe Prokurorinë si të korruptuar dhe shumë të korruptuar. Së fundi, te të anketuarit e BSBP-së vërehet një nivel i lartë i skepticizmit lidhur me

kompetencën e punonjësve të administratës publike.

Shumica e të anketuarve të BSBP-së besojnë se vetëm një grup i vogël i individëve janë punësuar në administratën shtetërore thjesht në bazë të meritave dhe kualifikimeve. Ndonëse në nivel pak më të ulët, qëndrime të ngjashme janë të pranishme edhe në raport me institucionet e sigurisë. Më shumë se 50 për qind e të anketuarve mendojnë se vetëm një pjesë e të punësuarve në institucionet e sigurisë janë aty falë meritave dhe kualifikimeve.

Ky raport u publikua në kuadër të projektit "Barometri i Sigurisë i Ballkanit Perëndimor".

BSBP shërben si një instrument për t'i matur perceptimet e qytetarëve të Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë për çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë, sundimin e ligjit, drejtësinë, bashkëpunimin rajonal dhe ndërtimin e paqes. Ky projekt rajonal udhëhiqet nga QKSS me mbështetjen financiare të National Endowment for Democracy (NED).

Kuvendi i Kosovës shpenzoi 8 milionë euro gjatë vitit 2021

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti vjetor i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2021, të cilin para deputetëve e ka paraqitur dhe arsyetuar sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi. Sipas tij, buxheti i Kuvendit të Kosovës ndahet në katër programe: deputetët e Kuvendit, administrata, stafi mbështetës politik dhe Komisioni për Ndhimë Shtetërore. Sipas sekretarit Krasniqi, shpenzimet për vitin 2021 për katër programet janë mbi 8 milionë euro, nga të cilat, rreth 6 milionë euro janë për paga, mëditje dhe shtesa. Pas prezantimit u hap diskutimi në lidhje me raportin vjetor, me ç'rast anëtarët e komisionit

shtruan pyetje në lidhje me shpenzimet të cilat morën përgjigje nga sekretari Krasniqi. Komisioni u pajtua që raporti të hidhet në votim në mbledhjen e radhës, pas disa plotësimeve. Për mbledhjen e ardhshme u shty edhe raportimi i Bankës Qendrore për të gjeturat e Raportit të Progresit për vitin 2021, ndërsa u shqyrtua kërkesa për caktimin e lartësisë së kompensimit të deputetit për funksion udhëheqës dhe kompensimin e shpenzimeve. Deputetët u morën vesh që në mbledhjen e ardhshme të diskutojnë sërish në lidhje me këtë pikë, pasi ta kenë në duar një hulumtim se si janë të rregulluara kompensimet e deputetëve në shtetet e BE-së dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe, po ashtu, t'i shohin propozimet nga shoqëria civile.




KPK-ja dhe KGJK-ja nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Jetish Maloku dhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Albert Zogaj, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për zbatimin e fazës transitore (fazës së katërt) të Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve (SMIL) në gjykatat dhe prokuroritë e vendit. Në ceremoninë e nënshkrimit u tha se ky akt i rëndësishëm ndërinstitucional nënshkruhet, duke pasur parasysh kompleksitetin e zbatimit dhe arritjet e deritashme të SMIL-it dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit të mëtejshëm mes KPK-së dhe KGJK-së, në mënyrë që të sigurohet një sistem i qëndrueshëm elektronik, i cili ndihmon në forcimin e sundimit të ligjit në

Kosovë në përputhje me standardet dhe vlerat e BE-së. Gjithashtu, KPK-ja dhe KGJK-ja u pajtuan se do të punojnë ngushtë në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zbatimin, financimin, planifikimin dhe organizimin e këtij projekti madhor digjital, me anë të të cilit mundësohet rritja e transparencës, efikasitetit dhe sigurohet funksionimi i drejtësisë në mënyrë më efektive, më cilësore dhe me kosto efektive. Me këtë rast, në përfundim të kësaj ceremonie, kryesuesit e dy këshillave nënshkruan edhe kërkesën e përbashkët drejtuar projektit EUKOJUST për lokacionin e Qendrës së Rimëkëmbjes për Teknologji Informativë, e cila do të përdoret për qëllime të gjykatave dhe prokurorive.



Shërbimi Korrektues lehtëson masat për vizitorë në institucione korrektuese



PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, bazuar në vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të pandemisë në vend, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të të burgosurve dhe stafit, nga data 3 mars ka ndërmarrë masa lehtësuese. "Hiqen kufizimet sa i përket numrit të vizitorëve për vizitat familjare ndaj

personave të privuar nga liria, vizitat familjare mund të realizohen sipas dispozitave ligjore në fuqi; Gjatë kohës së vizitës, vizitorët duhet t'i mbajnë maskat mbrojtëse; Secili vizitor para se të hyjë në institucionin korrektues, duhet ta dëshmojë certifikatën për vaksinim me dy doza, në rast të mosvaksinimit, vizitorët, duke përfshirë edhe personat nga mosha 12 deri në 16 vjeç, duhet ta posedojnë testin RT-

PCR negativ për Covid-19, jo më të vjetër se 48 orë; Lejohet shfrytëzimi i beneficioneve për të dënuar (vikend në shtëpi), në momentin e kthimit në institucion, i dënuari i cili nuk i ka marrë dy dozat e vaksinimit duhet ta dëshmojë testin për Covid-19, në rast se testi rezulton pozitiv, i njëjti duhet të karantinohet në institucionin korrektues për një periudhë prej shtatë ditësh", ka njoftuar Shërbimi Korrektues.

Edhe 1 000 familje në Lipjan me shporta të reja për mbeturina

LIPJAN, 2 MARS (ER) - Komuna e Lipjanit si fituese e Grantit të Performancës - Mjedisi i Pastër, të mërkurën ka

pranuar 1 000 shporta të reja për mbeturina që do të shpërndahen në familje të ndryshme në disa

lokalitete. “Kështu, me shpërndarjen e këtyre shportave po përfundon i gjithë procesi i

shpërndarjes së shportave të reja për çdo familje në Lipjan”, ka njoftuar komuna e Lipjanit.



Qeverisja lokale, temë diskutimi mes Brojës dhe Nicholsonit

Mitrovicë, 2 mars (ER) - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, Vesa Broja, ka pritur në takim Emily Nicholson, zëvendëshefe e

misionit në Ambasadën e Kanadasë. Kryesuesja Broja ka falënderuar Nicholson për vizitën e saj, pastaj e ka njoftuar me punën e

deritanishme të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, me prioritetet kryesore të qeverisjes lokale, si dhe janë diskutuar çështje të tjera me

rëndësi si transparenca dhe integrimi i femrës në proceset vendimmarrëse. Në fund të takimit kryesuesja Broja dhe përfaqësuesja e Ambasadës së

Kanadasë, Nicholson, u pajtuan për rritje të bashkëpunimit për çështje në interes të komunës dhe qytetarëve të Mitrovicës.



Drejtorja e Turizmit në Prizren fillon kurset për aftësim për zanate dhe punime dore

PRIZREN, 2 MARS (ER) - Komuna e Prizrenit, respektivisht Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, përsëri ka filluar kurset për aftësim për zanate dhe punime dore. Kurset do të mbahen në fushat e dizajnit për veshje, mefrushat, djege në dru, relief në letër, dizajni i bizhuterive dhe qëndisje në fjongo. “Të drejtë aplikimi kanë të gjithë vajzat dhe gratë, nga moshë 18 deri në moshën 45 vjeç. Të gjithë aplikuesit/et kanë të drejtë të jenë pjesëmarrës/e vetëm në një lloj të kursit. Aplikimet për



këto kurse do të pranohen në zyrat e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik”, ka njoftuar komuna e Prizrenit.

Në Gjilan mbahet sesion informues për thirrjen ‘Programi për Zhvillim Rajonal 2022’

Gjilan, 2 mars (ER) - Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Rajonal - Lindje (AZhR Lindje), ka organizuar të mërkurën në Gjilan punëtorinë, përkatësisht sesionin informues në lidhje me thirrjen “Programi për Zhvillim Rajonal 2022” (investime kapitale).

Të pranishëm në këtë punëtori ishin drejtorët e Drejtorive për Zhvillim Ekonomik nga 11 komunat e rajonit lindje, ndërsa nga Gjilani mori pjesë Enver Shabani, drejtor për Zhvillim Ekonomik, së bashku me Agim

Zekën, drejtor ekzekutiv i AZhR - Lindje. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte informimi sa më lidhur me këtë mundësi për financim të projekteve komunale dhe ndërkomunale. Vlera e projekteve me të cilat komunat mund të aplikojnë mund të jetë nga 50 mijë deri në 500 mijë euro.



Nis shenjëzimi i rrugëve në Kompleksin ‘Adem Jashari’

SKENDERAJ, 2 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka bërë me dije se ka filluar shenjëzimi horizontal në Kompleksin Përkujtimor

‘Adem Jashari’ në Prekaz. Ai ka thënë se më pas do të vazhdojnë gjatë rrugëve kryesore të qytetit. “Nga Kompleksi Përkujtimor ‘Adem Jashari’ në Prekaz, ku pas pak

ditësh do të mirëpresë dhjetëra mijëra vizitorë, në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së, kemi nisur shenjëzimin horizontal, për të vazhduar më pas përgjatë

rrugëve kryesore të qytetit, krejt kjo, edhe për këtë shënim historik, por edhe për ta rritur sigurinë në komunikacion”, ka shkruar Nura në llogarinë e vet në “Facebook”.

1 597 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të mërkurën nga 1 608 testime, 83 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit

është shënuar një rast i vdekjes.

Të mërkurën janë shënuar edhe 181 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 221 679. Në total numri i rasteve aktive

me Covid është 1 597.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 565 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 814 005 doza

të vaksinës. Deri më sot 816 442 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 97 722 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Krasniqi: Është emergjente nevoja e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i ka bërë thirrje qeverisë që t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për përshejtimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Krasniqi përmes një postimi në "Facebook" është shprehur se Partia Demokratike e Kosovës e sheh emergjente nevojën e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, krahas situatës së krijuar me sulmin ushtarak dhe pushtimin e paprovokuar të Ukrainës nga Rusia, i cili jo vetëm që po shndërrohet në tragjedi për një vend evropian por, po ashtu, po sulmon vlerat qytetërore e demokratike të cilat ne, Kosova dhe populli i saj i ndan me demokracitë perëndimore. "Në anën tjetër, përderisa dimensionet e agresionit rus ndaj Ukrainës po merr karakter të

një krize humanitare, Partia Demokratike e Kosovës i kërkon qeverisë që të ndajë një shumë prej së paku 1 milion eurosh për popullin e Ukrainës, si një ndihmë solide në këtë kohë jashtëzakonisht të rëndë për ta dhe vendin e tyre", ka shkruar ai.

Lideri i PDK-së njëkohësisht i bën thirrje qeverisë që të ndërmarrë masa për të siguruar, në rast nevojë, strehimin e së paku 5 000 qytetarëve ukrainas që janë shpërngulur dhunshëm nga agresioni rus. "Republika e Kosovës është produkt i forcave qytetare liridashëse që e kupton shumë mirë domethënien e një agresioni të tillë ndaj lirisë dhe demokracisë. Prandaj, ky moment duhet të shërbejë për t'i avancuar vlerat tona të përbashkëta dhe konsolidimin tonë të mëtejshëm në kuadër të strukturave demokratike evropiane dhe perëndimore", ka shkruar Krasniqi.

Zemaj: Problemet në shëndetësi janë të mëdha, sidomos në QKUK

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se problemet në shëndetësi janë të mëdha, sidomos në QKUK. Sipas tij, kjo situatë ka kaluar në nivel të degradimit. "Listat e pritjes në ortopedi, radiologji, kardiologji e shumë klinika të tjera janë shndërruar në luks e jo në ofrim të shërbimeve. Kjo është shqetësuese!", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se skandali më i madh është se kryesuesja e bordit është edhe kryesuese e

komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të klinikave. "Pra, qeveria e ka miratuar këtë. Janë parë keqpërdorime duke shpërndarë teste dhe duke shantazhuar profesionistë shëndetësorë me incizime. Fajtorë për këtë janë Ministria e Shëndetësisë dhe qeveria ku nga paaftësia për të menaxhuar e sidomos duke mos kërkuar përgjegjësi nga Bordi dhe menaxhmenti i ShSKUK-së. Shembujt e këqij janë të përditshëm tani dhe askush nuk ka dhënë përgjegjësi", ka thënë Zemaj.



Presidentja Osmani shkon për vizitë në Maltë

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka nisur një vizitë pune në Maltë, me ftesë të presidentit të Maltës, George Vella, nën përkujdesjen e të cilit do të mbahet Forumi për

Paqe dhe Kulturë. Përveç takimit me homologun, presidentin Vella, Osmani do të takohet edhe me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve, Angelo Farrugia, dhe Ministrin e Jashtëm të Maltës,

Evarist Bartolo. Në Forumin për Kulturë dhe Paqe presidentja Osmani do të jetë paneliste krahas presidentëve të tjerë, në tryezën ku do të diskutohet për rolin e liderëve botërorë në paqe.



Agresioni rus në Ukrainë prek edhe Trustin, 90 milionë euro humbje

PRISHTINË, 2 MARS - Agresioni ushtarak rus në Ukrainë ka pasur ndikim të menjëhershëm në tregjet ndërkombëtare. Një krizë e tillë pashmangshëm ka goditur edhe Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës - Trustin si rrjedhojë e investimit të këtij fondi në tregjet ndërkombëtare financiare në Evropë dhe në ShBA.

Zyrtarë të Trustit kanë konfirmuar për "KosovaPress" se si pasojë e kësaj krize në tregjet ndërkombëtare financiare Trusti ka pësuar rënie prej 90 milionë eurosh, ndërsa ekspertë bankarë kërkojnë nga Trusti që të marrin masa sa iu përket investimeve të mjeteve të fondit në tregjet ndërkombëtare.

Zëdhënësi i Trustit, Jeton Demi, ka thënë se agresioni ushtarak i Rusisë në Ukrainë rrjedhimisht ka prekur edhe pjesën e investimeve të Trustit me një tkurrje përreth 4 për qind. Megjithatë, Demi thotë se nuk ka vend për t'u alarmuar. "Kemi një reduktim të vlerës së përgjithshme të Fondit me rreth 90 milionë euro deri më tani ose rreth 4 për qind, por duke qenë se jemi pas një viti me rritje shumë të lartë, në vitin 2021 u ngritëm me gati 11 për qind ose rreth 220 milionë euro kthim nga investimet, ende kemi hapësirë për t'u mos u alarmuar përkundër që masat e marra nga bordi drejtues dhe monumenti kanë qenë në nivel të detyrës së shqetësimit dhe ndjeshmërisë së situatës

së re. Gjithçka në jetën tonë po preket shumë më fuqishëm sesa mjetet pensionale, kështu që shumëçka po na kushton shumë më shtrenjtë. Fjalori i përdorur së fundmi nga liderët e shteteve bërthamore përfshirë sidomos Rusinë që ka përmendur mundësinë e përdorimit të armëve bërthamore është një alarm shumë i fortë dhe që prek sigurinë dhe cenon sigurinë investuese globale. Andaj, lëvizjet, rëniet e vlerës për momentin janë të pritshme dhe të arsyeshme për situatën që kemi", u shpreh Demi. Sipas Demit, pozicionimi i fundit gjeografik i Trustit për investime ka qenë me praninë më të lartë në tregun e Evropës dhe pak të ulët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Megjithatë, Demi thotë se kanë marrë një vendim të rëndësishëm për t'u mos u afektuar të paktën kontribuuesit që tani më janë në prag të pensionimit. "Zgjidhjet e ofruara nga bordi dhe menaxhmenti në këtë rast, është që të gjithë kontribuuesit që kanë arritur moshën 65-veçare më 16 shkurt të këtij viti do të kalojnë në një plan investues konservativ dhe mjetet e tyre nuk do të preken nga lëvizjet në tregjet financiare ndërkombëtare, do të jenë pjesë e investimeve tona në bonot e thesarit të Kosovës të cilat historikisht kanë pasur një kthim nga investimet rreth 3 për qind. Pra, kjo është masa më e re që ka



qenë e projektuar dhe e punuar për disa vjet nga Trusti, që të kemi mbrojtje më të lartë të kontribuuesve që janë më afër pensionit dhe që nuk kanë kohë t'i rikuperojnë rëniet ose luhatjet eventuale", ka theksuar ai.

Profesoresha universitare Albulenë Kastrati ka thënë se edhe fondi i Trustit pashmangshëm do të pësojë humbje si pasojë e kësaj lufte në Ukrainë.

Profesoresha Kastrati ka kërkuar nga bordi dhe

menaxhmenti i Trustit që ta rishikojnë vendimin për investimet e kontributeve në këto tregje ndërkombëtare. "Performanca e tyre varet direkt nga performanca e indekseve dhe tregjeve ku janë ta plasuar. Menjëherë pas krizës Ukrainë - Rusi, të gjitha bursat ndërkombëtare në Evropë, në Amerikë, në Japoni, në Londër janë afektuar dhe shumica prej tyre kanë pësuar rënie, kështu që në aspektin e Trustit Pensional kemi shumë ekspozime, 90 për qind të

kontributeve tona dhe varësisht si përforcojnë këto tregje, ashtu do të performojë edhe kthimi i kontributeve tona. Prandaj është e pashmangshme që një pjesë këtyre kontributeve mund të pësojnë humbje[...] Ky kombinim i aseteve ose plasimeve nëpër tregjet ndryshme duhet të rishikohet", thotë Kastrati. Vitet e fundit është rritur vazhdimisht numri i kontribuuesve në Trust, ku aktualisht edhe fondi ka arritur rreth 2.3 miliardë euro.

Kryetari i AKB-së: Kosova dhe Shqipëria të veprojnë si treg i përbashkët

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Një delegacion i kryesuar nga kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, dhe i DHKT-së, i shoqëruar nga nënkryetari Suat Berisha dhe drejtoresha menaxhuese Lumnije Ajdini, kanë takuar ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjeve në Republikën e Shqipërisë, Edona Bilali.

Shahini ka thënë se dy qeveritë kanë nënshkruar dhjetëra marrëveshje bashkëpunimi ekonomiko-social në fusha të ndryshme për ta avancuar bashkëpunim ndërmjet sipërmarrësve në të dyja anët por, sipas tij, ende mbetet shumë për t'u bërë në ngritjen e këtyre kapaciteteve, në mënyrë që të rritet vetëdija kombëtare për konsum të produkteve vendore.

"Shkëmbimet tregtare të të dy shteteve tona janë drejt rritjes, por duhet që shtetet të bëjnë më shumë ashtu edhe bizneset të kenë bashkëpunim me konsumatorin që të joshin produkte dhe shërbime me cilësi më të lartë. Gjithashtu të promovojnë besueshmëri më të madhe te qytetarët dhe turistët e shumtë që ka Shqipëria dhe Kosova, në mënyrë që të veprojnë si një treg i përbashkët kundrejt konkurrencës së ashpër nga shtetet dhe korporatat e fuqishme të huaja", ka thënë kryetari i AKB-së, Agim Shahini.

Ministrja Edona Bilali ka thënë se mbështesin çdo iniciativë të sipërmarrësve të të dyja vendeve në të mirë të rritjes së bashkëpunimit dhe promovimit të vlerave




ekonomike kombëtare. "Ne jemi të gatshëm të mbështesim çdo iniciativë që vjen nga bizneset dhe do të

jemi kontakti i parë i qeverisë shqiptare për rritjen e investimeve, prodhimeve, punësimeve dhe eksporteve të

çdo produkti kualitativ që ka synim tregun e brendshëm dhe të jashtëm", ka thënë Bilali.

Si i ka shpëtuar Vladimir Putin 7 atentateve, dhe këshillat që mori personalisht nga Fidel Kastro



Vladimir Putin ka bërë shumë armiq gjatë karrierës së tij të gjatë politike. Pas një angazhimi 15-vjeçar në radhët e KGB-së sovjetike, ai kreu punë të ndryshme përpara se ish-presidenti Boris Jelcin ta emëronte në vitin 1999 në postin e kryeministrit.

Në fund të po atij viti, ai mori postin e presidentit të Rusisë pasi dorëheqjes së Jelcin. Një pozicion që ai e mbajti zyrtarisht në vitet 1999-2008. Për 4 vite ai mbajti postin e kryeministrit, ndërsa u bë sërish president në vitin 2012, post që e mban ende sot.

Ai ka ndryshuar edhe kushtetutën e vendit, dhe sipas planeve të tij synon të jetë në pushtet deri në vitin 2036. Karriera e tij si një lider autokrat është e mbushur me ngjarje tragjike, kur kritikët e Putinit janë vrarë ose zhdukur në rrethana të dyshimta ose misterioze.

Për shembull, gazetarja investigative Natalia Estemirova, që po hetonte disa raste vrasjesh dhe rrëmbimeve në Çeçeni, u qëllua për vdekje në një pyll afër shtëpisë së saj. Apo rasti i Boris Berezovskit, një lider politik dhe njeri shumë i pasur. Në fillim një mik i Putin, ai u zotua publikisht se "do ta rrëzonte" presidentin rus.

Pak vite më vonë u gjet i vdekur në shtëpinë e tij në Londër. Të dhënat e para folën për një vetëvrasje. Por hetimet e mëvonshme, e gjetën jo shumë bindëse këtë tezë. Vetë Putin

mohoi çdo përfshirje në atë ngjarje. Por vetë ai ka qenë objekt i shumë atentateve dhe kompleteve gjatë më shumë se 2 dekadave në pushtet.

Gjatë një dokumentari të vitit 2017, regjisorin amerikan Oliver Stoun përmendi se faktin që Putini kishte shërbyer deri atëherë 3 mandate si president, duke qenë objekt i 5 tentativave për vrasje. Putin u vu për herë të parë në shënjestrën e atentatorëve, kur ishte duke marrë pjesë në funeralin e mikut të tij Anatoli Sobçak në Shën Petersburg më 24 shkurt 2000.

Shërbimi Federal i Gardës ndërhyri në kohë, duke i shpëtuar jetën. Zëdhënësi për media i Shërbimit Federal të Gardës, Sergei Devistov, deklaroi në atë kohë se pas atentatit "nuk qëndronte një psikopat, por një organizatë e caktuar".

Po atë vit pati një tjetër atentat të mbetur në tentativë, që u arrit të parandalohet në kohë nga forcat e sigurisë. Një grup ish-udhëheqësish rusë po takoheshin me liderët botërorë në samitin e Jaltës të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura.

Gjatë samitit, që u zhvillua në datat 18-19 gusht 2000, një person u ndalua në momentin kur donte të vriste Putinin. Edhe pse dokumentet për atë ngjarje mbeten të klasifikuara, u arrestuan 4 çeçenë dhe një numër i paspecifikuar shtetasish nga Lindja e Mesme.

Në vitin 2002, Putin ishte sërish në rrezik. Tre muaj përpara se të vizitonte kryeqytetin Azerbajxhanit, Baku, autoriteteve azere iu dhanë informacion mbi një atentat të mundshëm që do të ndodhte në janarin e 2002-it. Një shtetas irakian me lidhje me Afganistanin dhe forcat rebele çeçene, kishte planifikuar një atentat me eksploziv.

Ai u arrestua, së bashku me personin që i dërgoi eksplozivin, Kianan Rostam, dhe u dënua me 10 vjet burg. Vetëm një muaj më vonë, pati një kërcënim tjetër, shumë më i rrezikshëm. Një burrë hyri me forcë me makinë në kompleksin e Kremlinit, dhe doli nga makina e tij për të folur me anëtarët e rojave të sigurisë. Ai tha: "Quhem Ivan Zaitsev. Unë jam presidenti i Rusisë. Tani më çoni tek Vladimir Putini!". Gardistët u befusuan nga ajo që panë, kontrolluan dokumentet e tij dhe më pas e dërguan Zaitsev për ta vizituar në një spital psikiatrik që ndodhej aty pranë. Mjekët i thanë se Zaitsev kishte tentuar të bënte të njëjtën gjë në vitin 2001, dhe të dyja herët u kishte thënë njerëzve plot entuziazëm se donte të vriste Putinin. Ai u tha psikiatërve të tij se Putini po sillte nazizmin në Rusi, dhe se ai ishte një spiun i fshehtë. "Dua që t'i pres kokën Putini!"-shkroi ai në ditarin e tij. Ai ishte i bindur se po hakmerrej për vëllain e tij, që kishte vdekur me prerje koke disa vite më parë. Atentati tjetër ndodhi në

nëntorin e vitit 2002, kur Putini supozohej të lëvizte përgjatë autostradës Rublevo-Uspenskoje, pikërisht afër selisë së Kremlinit.

Aty ndodhej një grup njerëzish që pretendonin se po vendosnin disa tabela të reja rrugore në autostradë. Vetëm disa orë më vonë, një media raportoi se policia kishte gjetur mbi 40 kilogramë eksploziv të vendosur enkas për të shpërthyer përgjatë autostradës.

Por komploti i zbulua na kohë, dhe eskorta e Vladimir Putinit ndoqi një rrugë tjetër. Edhe sot e kësaj dite, zyrtarët refuzojnë të komentojnë mbi atë ngjarje, dhe madje e mohojnë që ajo të ketë ndodhur ndonjëherë. Diçka shumë e ngjashme ndodhi vitin që pasoi.

Në qershorin e vitit 2003, një autostradë që lidh Shën Petersburg dhe Pskovin u vu në shënjestër, ndërsa presidenti Putin supozohej që të kalonte atje. Këtë herë, policia gjeti një bombë të prodhuar shumë dobët në mënyrë artizanale të fshehur në një çantë.

Ehe në atë rast, askush nuk u dëmtua, dhe sërish zyrtarët rusë e mohuan komplotin. Agjencia e njohur e lajmeve "Reuters" raportoi në vitin 2008, se një snajper goditi pa sukses drejt Putinit, në kohën kur ky po largohej nga zyra e presidentit të ri Dimitri Medvedev.


Thuhet se të dy po bënin një shëtitje në parkun e kompleksit,

pasi Medvedev fitoi zgjedhjet presidenciale të atij viti. Tentativa e radhës ka ndodhur në vitin 2012. Një grup çeçenësh planifikuan të shpërthenin një bombë në anë të rrugës. Por sërish plani u sabotua në kohë. Edhe pse është e vështirë të përcaktohet numri i saktë, Putin u ka shpëtuar të paktën 7 tentativave për vrasje. Ato nuk kanë pasur sukses për shkak të masave të rrepta të sigurisë.

Në intervistën e 2017-ës me Oliver Stoun, Putin pranoi të fliste për atentatet e dështuara kundër tij, duke thënë se në atë kohë se kishte pasur 5 tentativa për ta vrarë.

Putin e pranoi se kishte shkuar aq larg sa të kërkonte këshilla nga një udhëheqës tjetër, që kishte shumë përvojë në këtë fushë. Ai kishte pyetur presidentin e Kubës, Fidel Kastro, mbi detajet e masave të tij të sigurisë. Mendohet se Kastro ka qenë objektivi i më shumë se 600 tentativave për vrasje. Të gjitha dështuan, dhe ai jetoi deri në moshën 90-vjeçare.

Putin e kujton kështu atë bisedë: "Kam biseduar me Kastron mbi çështjen e atentateve. Dhe ai më tha: E di pse jam ende gjallë? Sepse jam marrë personalisht me sigurinë time". Putin shtoi: "Unë bëj punën time, dhe oficerët e sigurimit bëjnë të tyren, dhe deri më tani ata janë shumë të suksesshëm në atë që po bëjnë". / Grunge - Bota.al



EURO GLASS
SAINT-DORAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Më 6 prill zgjedhjet për kryetar të FFK-së

PRISHTINË, 2 MARS (ER) - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), nën drejtimin e kryetarit Agim Ademi, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës. Në këtë mbledhje është vendosur që zgjedhjet për kryetar të FFK-së të mbahen më 6 prill, ndërsa për vendin dhe kohën e mbajtjes delegatët do të njoftohen në ditët në vazhdim. "Në këtë mbledhje KE vendosi që në bazë të statutit dhe rregullores t'i shpallë zgjedhjet për kryetar. Me këtë rast u vendos që Kuvendi i Rregullt Zgjedhor për kryetar të FFK-së të mbahet më 6 prill, ditë e mërkurë. Delegatët do të



FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS

njoftohen në ditët në vazhdim për orën dhe vendin e mbajtjes së Kuvendit", thuhet në njoftimin e FFK-së. Përveç kryetarit aktual, Agim Ademit, pozitën e të parit të futbollit e synojnë edhe Arianit Ahmeti,

Remzi Ejupi, Gramoz Vokrri, Bekim Shotani dhe Nexhat Dumnica. Po për këtë pozitë është lakuar edhe emri i Afërdita Fazlijes, ish-përzgjedhëse e përfaqësueses së femrave.

Hendbollistë dhe hendbolliste nga Brazili 'aterrojnë' në Kosovë



PRISHTINË, 2 MARS - Ka përfunduar tashmë afati për angazhimin e lojtarëve të huaj. Janë dy skuadra të hendbollisteve që i kanë shfrytëzuar çastet e fundit të këtij afati. Më herët KH Kastrioti angazhoi plot katër lojtarë. Bëhet fjalë për brazilianin Guilherme Da Silva Fernandez, Samid Mekiçin nga Mali i Zi dhe Martin Bozhinovskin dhe Adis Saliun nga Maqedonia e Veriut. Me angazhimin e katër lojtarëve nga vendet e tjera

bëhet me dije se Kastrioti ka synime më të mëdha për vazhdimin e kampionatit. Ndërkohë në vazhdim të kampionatit në klubet tona do të luajnë katër hendbolliste nga Brazili. KHF Ferizaj ka paraqitur për regjistrim tri lojtare braziliane. Njëra prej tyre ka debutuar fundjavën e kaluar ndaj Istogut. Bëhet fjalë për Ligia Costa. Dy brazilianet e tjera për të cilat ka paraqitur kërkesë për regjistrim Ferizaj janë Ana Luisa Lira Chaves dhe Larissa Inae Da Silva. Pritet që

ato të jenë përforsim i madh për skuadrën ferizajase. Lideri i Superligës, Istogu, ka paraqitur për regjistrim brazilianen Dayane Rocha. Ajo ka karrierë të gjatë dhe të suksesshme si në nivel klubesh ashtu edhe me Kombëtaren e Brazilit. Malazezja Angjela Kovaçević është lojtarja tjetër për të cilën ka paraqitur kërkesë KHF Istogu. Istogu, po ashtu, ka kthyer në përbërje Elma Kamerin, që për shumë vjet ishte prej hendbollisteve më të dalluara në Kosovë.

SHKURT

Ndërroi jetë ish-hendbollistja e KHF Vjosa

Ish-hendbollistja Behare Brahaj-Ismajli ka vdekur. Lajmin e ka dhënë klubi në të cilin e ndjera ka qenë pjesë në kohët më të mira, KHF Vjosa. "Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të Behare Brahaj-Ismajli, lojtare e kohës së artë të KHF Vjosa. KHF Vjosa u shpreh ngushëllime më të sinqerta familjes, bashkëlojtareve si dhe komunitetit sportiv", thuhet në njoftimin e klubit.

Zgjedhjet në FShF shtyhen më 15 mars

Asambleja për President të Federatës Shqiptare të Futbollit është dashur të mbahet sot, pas një vendimi të gjykatës së Tiranës e cila e ka pezulluar atë. Delegatet kanë qenë të detyruar të vendosin për shtyrjen e saj për një datë tjetër. Është vërtet e pazakontë ajo që ka ndodhur në Shqipëri, por ja që gjërat ndodhin. Është miratuar zhvillimi i zgjedhjeve për president të FShF-së dhe Komitetit Ekzekutiv me datë 15 mars.

Krasniqi jep dorëheqje nga pozita e kryetarit të FKK-së

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të Federatës së Karatesë së Kosovës, duke thënë se për shkak të angazhimeve të shumta nuk mund të mbante dy pozita. "Për shkak të angazhimeve të shumta si president i KOK-ut, dhe pamundësisë për ta dhënë maksimumin edhe në karate, kam dashur t'ua hap rrugën të tjerëve për ta udhëhequr karatenë dhe vazhduar punën aty ku unë e kam lënë. Falënderoj Bordin Ekzekutiv të FKK-së, sekretarin e përgjithshëm, Nazmi Gashi, karateistët, trajnerët, gjyqtarët dhe gjithë komunitetin e karatesë për përkrahjen dhe bashkëpunimin që kishim", ka thënë Krasniqi, i cili ia ka paraqitur dorëheqjen Bordit Ekzekutiv të Federatës së Karatesë në mbledhjen e fundit. Presidenti i KOK-ut ishte kryetar i FKK-së prej vitit 2016.

Klitschko: Rusia po vazhdon 'marshimin' drejt kryeqytetit, por Kievi do të qëndrojë

Vitali Klitschko, kryetar i Kievit, ka thënë se trupat ruse janë duke vazhduar që të afrohen edhe më drejt qendrës së kryeqytetit. Paraprakisht është raportuar se një konvoj i gjatë i veturave ruse ishte 28 kilometra larg Kievit, raporton "Sky". Ky grup ka lëvizur ngadalë drejt kryeqendrës ditë e fundit, por që dje është parë të ketë ngecur. "Jemi duke u përgatitur dhe do ta mbrojmë Kievin. Kievi qëndron dhe do të qëndrojë".

Turneu 'Adem Jashari' në futsall ndryshon format

Turneu "Adem Jashari" në futsall i paraparë të mbahet gjatë tre ditëve (më 2/3/4 mars), ka ndryshuar format dhe do të mbahet vetëm me një ndeshje ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, që zhvillohet më 3 mars në ora 20:00, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Ndërsa para kësaj ndeshje do të luhet takimi ndërmjet Veteranëve të UÇK-së dhe Përfaqësueses së Veteranëve të Kosovës. Ky ndryshim erdhi si pasojë që Përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut nuk arriti të vijë për të qenë pjesë e këtij eventi, edhe pse paraprakisht e kishte konfirmuar pjesëmarrjen.

KOK-u i dërgon letër mbështetëse Komitetit Olimpik të Ukrainës

PRISHTINË, 2 MARS - Komiteti Olimpik i Kosovës i ka dërguar letër solidarizimi dhe mbështetëse Komitetit Olimpik të Ukrainës pas ngjarjeve të fundit. Që nga java e kaluar Ukraina ndodhet në luftë me Rusinë, e cila është duke u sanksionuar nga bota e sportit, bashkë me

mbështetësin e tyre, Bjellorusinë. Në letërën e dërguar nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, për homologun e tij, Sergey Bubka, kujtohen vuajtjet e popullit të Kosovës nga lufta e fundit në Kosovë. “Në këto ditë të vështira për popullin tuaj, Komiteti Olimpik i Kosovës dhe gjithë populli

ynë shpreh solidaritetin dhe mbështetjen e plotë për kauzën tuaj dhe shpresën për sigurinë tuaj. Ne ndiejmë të njëjtin trishtim me ju, pasi kjo luftë na sjell kujtimet, kur ne po vuanim luftën 23 vjet më parë nga fqinji ynë Serbia”, thuhet në letërën e presidentit Krasniqi. KOK-u, gjithashtu,

mbështet fuqishëm sanksionet e vëna nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe Federatat Ndërkombëtare Sportive për sportistët e Rosisë dhe Bjellorusisë. KOK-u ka bashkëpunim të mirë me Komitetin Olimpik të Ukrainës, ndërsa presidenti i KO të Ukrainës,



Sergey Bubka, i kishte ndarë medaljen e artë olimpike, Distria Krasniqit, në Lojërat Olimpike “Tokio 2020”.

Abramovichi kërkon 3 miliardë funte për shitjen e Chelseat

LONDËR, 2 MARS - Roman Abramovichi është i gatshëm ta shesë klubin e tij, Chelsea. Miliarderi rus, në fakt, e ka ndër mend t'i shesë të gjitha pronat që i ka në Britaninë e Madhe, ku është shpallur “persona non grata” pasi iu ndalua hyrja dhe jetesa në ishull. E tash mediet britanike e kanë zbuluar edhe shumën e parave që e kërkon rusi me pasaportë izraelite. “Daily Mail” zbulon se Abramovichi i kërkon 3 miliardë funte, respektivisht afro 3,6 miliardë euro për shitjen e klubit londinez. Miliarderi zviceran Hansjorg Wyss është i interesuar për ta blerë klubin dhe palët janë duke diskutuar për një shit-blerje eventuale. Manjati i medikamenteve është i gatshëm të bëhet pjesë e konsorsiumit me 2 miliardë funte të shpenzuara. “Si të gjithë oligarkët e tjerë, Abramovichi është, po ashtu, në panik. Ai po mundohet t'i shesë vilat e tij në Angli. Ai dëshiron ta shesë edhe Chelsea sa më shpejt. Unë dhe njerëz të tjerë kemi marrë ofertë të martën për ta blerë Chelsea nga Abramovichi”, ka deklaruar



miliarderi zviceran për mediumin “Blick”. “Më duhet të pres edhe katër ose pesë ditë. Abramovichi për momentin po kërkon shumë. Unë jam i gatshëm t'i ofroj 2 miliardë euro”, ka vazhduar Wyss. “Sot për sot nuk e dimë saktë çmimin e shitjes. Unë do ta imagjinoja veten duke hyrë në Chelsea me partnerë, mirëpo më duhet t'i shikoj mundësitë gjenerale fillimisht. Nuk do t'i hyj kësaj pune i vetëm, kjo është e sigurt. Nëse e blej Chelsea, më pas do të jemi 6 ose 7 investitorë”, ka përfunduar ai. Por, Abramovichi thuhet se është duke shikuar që ta shesë sa më shpejt të

jetë e mundur klubin që e kishte blerë në vitin 2003. Ai po përballet me sanksione nga Britania e Madhe pasi konsiderohet si njeri i afërt me presidentin rus Vladimir Putin, i cili po mundohet ta pushtojë Ukrainën. Abramovichi po mundohet t'i shesë, po ashtu, edhe pronat e tij të shumta në Londër, të cilat e kapin shifrën e më shumë se 1 miliard eurosh. Kohën e fundit ai po qëndron në Emiratet e Bashkuara Arabe, në tentim për t'i shitur pronat në Britaninë e Madhe. Chelsea ka qenë një prej klubeve më të suksesshëm në botë që kur e kishte blerë ai në fillim të shekullit.

Lakersat regjistrojnë humbjen e tretë radhazi, humbasin edhe Brooklynin dhe Golden State

LOS ANXHELOS, 2 MARS - Humbja e tretë radhazi për Lakersat, që tashmë janë me një këmbë jashtë “play-off”-it. Kalifornianët u mundën me rezultat 109-104 nga Dallasi. LeBron Jamesi realizoi 26 pikë e 12 rebounde, por që s'mjaftuan, ndërsa për teksanët u dallua Doniqi me 25 pikë. Zhgënjën edhe skuadra e Brooklynit që, gjithashtu, rrezikon



“play-off”-in në Lindje. Ekipi i Netsit u mund 109-108 nga Toronto, një ndeshje me rivalitet deri në fund. Për kanadezët u dallua Trent me 24 pikë, ndërsa për miqtë mungoi lojtari lider. Një moment jo

të mirë po kalon edhe Golden State, që u mund me shifrat 129-114 nga Minnesota. Curry realizoi 34 pikë, por që mbetën për statistikë, ndërsa për vendasit u dallua Towns me 39 pikë, më i miri në fushë.

REZULTATET

| | |
|--------------------------|---------|
| Washington - Detroit | 116-113 |
| Boston - Atlanta | 107-98 |
| Toronto - Brooklyn | 109-108 |
| Houston - Clippers | 100-113 |
| Minnesota - Golden State | 129-114 |
| Lakers - Dallas | 104-109 |

SHKURT

Rusët duhet të garojnë si neutralë në Lojërat Paralimpike

Atletët paralimpikë nga Rusia dhe Bjellorusia duhet të garojnë si neutralë në Lojërat Paralimpike Dimërore që do të mbahen në Pekin. Në një deklaratë të Komitetit Ndërkombëtar Paralimpik është thënë se atletët – që tashmë kanë arritur në Kinë – do të garojnë me flamurin paralimpik. “Ata nuk do të përfshihen në tabelën e medaljeve”, ka thënë Komiteti. Në deklaratë është thënë se Komiteti ka marrë “veprimet më të ashpra” brenda parametrave që i lejohet. Lojërat Paralimpike hapen të premtën, ndërsa garant nisin të shtunën.

Notari i njohur ukrainas dëshiron t'i bashkohet luftës kundër Rosisë

Lista e sportistëve ukrainas që po i bashkohen luftës kundër Rosisë sa vjen e rritet. Mykhailo Romanchuk, notari i njohur ukrainas, e ka ndër mend t'i bashkohet ushtrisë për ta mbrojtur atdheun. Ai është i gatshëm të qëndrojë në vijën e parë të frontit për ta luftuar agresorin rus. Këtë e ka bërë me dije rivali i tij i madh në pishinë, Gregorio Paltrinieri. “Është një situatë absurde. Dëgjohe me të çdo ditë. Ai jeton në periferi të Kievit. Dje më ka thënë se po zhvendosej sepse po i ndien sirenat. Ai ndërkohë dëshiron të luftojë për vendin e tij. Besoj se tashmë është organizuar për të bërë këtë”, ka deklaruar notari italian. Ushtrisë ukrainase më herët i janë bashkuar edhe vëllezërit Klitschko, ish-kampionë të botës dhe kampioni aktual i botës në boks, Usyk.

Pioli: Milani e meritonte fitoren ndaj Interit

Trajneri Stefano Pioli ka thënë se Milani e meritonte të fitonte ndeshjen ndaj Interit në gjysmëfinalen e Kupës së Italisë (0-0). Mirëpo trajneri Pioli është shfaqur i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve kuqezi. “Milani luajti mirë dhe meritonte diçka më shumë, por nëse e shikojmë në të dyja ndeshjet, është një rezultat i mirë. Unë ende mendoj se e merituar një fitore këtë mbrëmje. Është vetëm një rezultat i pjesshëm, e dimë se i dyti do të jetë shumë i vështirë, por jam i kënaqur me paraqitjen. Kemi bërë progres gjatë dy vjetëve e gjysmë të fundit. Do të dëshironim të fitonim diçka dhe ta bënim këtë një sezon të mrekullueshëm”, ka thënë Pioli. “Zgjodha ekipin që ishte më i miri për këtë ndeshje, bazuar edhe në karakteristikat taktike. Nuk po mendoja fare për Napolin. Ky është një tjetër provë shumë e vështirë, por sa më e ashpër të jetë pengesa, aq më e kënaqshme është për t'u kapërcyer”, ka shtuar Pioli.

PSG-ja, ofertë të re për Mbappen

Paris Saint-Germain i ka bërë ofertë të re Kylian Mbappes për ta pranuar qëndrimin edhe për sezonin e ardhshëm. 23-vjeçarit i skadon kontrata në fund të sezonit dhe mund të largohet me parametra zero nga PSG-ja, me gigantët spanjollë të Real Madridit që po

tentojnë me çdo mënyrë për të nënshkruar me francezin. Mbappe ka refuzuar një sërë ofertash për rinovim me PSG-në deri më tani, por parisienët janë të vendosur të mbajnë sulmuesin, i cili ka shënuar 156 gola në 205 ndeshje për klubin që kur u bashkua nga

Monaco në vitin 2017. “Le Parisien” raporton se të PSG-ja janë të përgatitur për ta bërë Mbappen lojtarin më të paguar në botë, duke i ofruar atij një marrëveshje të re dyvjeçare me vlerë 960 000 euro në javë pa taksa. Mbappe do të merrte edhe një pagesë nënshkrimi prej

100 milionë eurosh për të qëndruar në “Parc des Princes”. Përfaqësuesit e Mbappes ende nuk i janë përgjigjur ofertës, por PSG raportohe se është optimiste për ta bindur sulmuesin që të mbetet në klub pas diskutimeve pozitive me agjentët e tij.



Shqiptarë Humanitare "Mëjta Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarne Dobrotvorne Udruženje Kosova "Mëjta Teresa"
38400 Prishtinë, Rr. Agim Krasniqi, p.n. Të 04/01/81 38 542 864, Fax: 542 869.
Web site: www.mothersociety.org e-mail: mothersociety@sho.com

CONTRACT NOTICE SUPPLIES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 02/03/2022

| | | | | |
|----------------|-----------|-----|------|-----|
| Procurement No | Equipment | 001 | 2022 | 121 |
|----------------|-----------|-----|------|-----|

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

| | | |
|---|--------------------|------------------------|
| Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa" | | |
| Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1 | | |
| Town: Prishtina | Postal code: 10000 | Country: Kosovo |
| Contact point(s): Zef Shala | | Telephone: 038-542-865 |
| Email: zefshala@hotmail.com | | Fax: 038-542-869 |
| Internet address (if applicable): | | www.mothersociety.org |

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

| | |
|--|--|
| II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Supplies with Bag Equipment for 250 Beneficiaries-Returnees and people at risk off illegal emigration | |
| II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract) | |
| <input type="checkbox"/> Supplies | |
| Main place of delivery According to the request from Contracting Authorities | |
| II.1.5) Short description of the object of the contract Supplies with Bag Equipmients-Returnees New beneficiaries- Returnees, and people at risk off illegal emigration. | |
| II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) | |

93.000.000.08

II.1.7) Variants are accepted

II.1.8) Division into lots Yes box only
If yes, tenders may be submitted for (tick one)
 All lots

II.1.9) In case of one or more Lots (if applicable)
The maximum number of Lots that may be awarded to one Economic Operator is: [insert number]

II.1.10) Information about lots (if applicable)

| Loti nr. | Përshkrimi i llotit |
|----------|--|
| 1 | Hairdressing - Package 1 / Floktari - Pako 1 |
| 2 | Hairdressing - Package 2 / Floktari - Pako 2 |
| 3 | Barber / Berber |
| 4 | Electrical Installation / Instalues i Elektrikes |
| 5 | Auto Service / Auto Mekanik |
| 6 | Auto Electrical Equipment / Pajisje për Auto Elektricist |
| 7 | Construction - Facade / Ndërtimtari - Fasader |
| 8 | Construction - Tiling / Ndërtimtari - Keramik |
| 9 | Construction Masonry - Brick Layer / Ndërtimtari - Murator |
| 10 | Carpentry / Zdrukthëtari |
| 11 | Tailoring - Package 1 / Rrobaqepësi - Pako 1 |
| 12 | Tailoring - Package 2 / Rrobaqepësi - Pako 2 |
| 13 | Welding / Saldim |
| 14 | Central Heating Installation and Plumbing/ Instalues për Ngrohje Qendrore dhe Ujësjellës |
| 15 | IT Equipment / Pajisje të Teknologjisë Informative |
| 16 | Gastronomy Equipment / Pajisje për Gastronomi |
| 17 | Equipment's for bakery - Pizza / Pajisje për furrтари - Pica |
| 18 | Equipment's for pastry - Sweet Shop / Pajisje për pastiqeri - Embëlsira |
| 19 | Car Wash Equipment / Pajisje për auto larje |
| 20 | Greenhouse Equipment / Pajisje për Serra (Bashqe) |
| 21 | Livestock - Package 1 / Blegtori - Pako 1 |
| 22 | Livestock - Package 2 / Blegtori - Pako 2 |
| 23 | Agriculture / Bujqesi |
| 24 | Agriculture product processing / Përpunimi i produkteve bujqësore |

| | |
|----|--|
| 25 | Beekkeeping - Package 1 / Bletari - Pako 1 |
| 26 | Beekkeeping - Package 2 / Bletari - Pako 2 |

II.1.11) Estimated contract value: 250,000.00 Euro

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 3 or days 90 (from the contract signature)
or
Starting 15/04/2022
Completion 31/07/2022

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

| | |
|---|-----------------------------|
| III.1.1) Performance security required | No <input type="checkbox"/> |
| III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable) | |
| III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject | No <input type="checkbox"/> |

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

| |
|--|
| III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary |
| III.2.2) Professional Suitability: 1. Licens Registration Certificate 2. List of Employees professional and administrative staff-CV Euro- pass individually Documentary evidence required: Copy of documentary |
| III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo for winner Company 2. Bank Certificate of active Client for winner Company 3. Certificate from Justice for Winner Company Documentary evidence required: Copy of documentary |
| III.2.4) Technical and professional capacity Documentary evidence required Copy of documentary |

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

| | |
|---|------------------------------|
| III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession | No <input type="checkbox"/> |
| III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the supplies | Yes <input type="checkbox"/> |

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

| | |
|---------------------------|-------------------------------|
| IV.1.1) Type of Procedure | <input type="checkbox"/> Open |
|---------------------------|-------------------------------|

IV.2) AWARD CRITERIA

| |
|---------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Lowest price |
|---------------------------------------|

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

| | |
|--|-----------------------------|
| IV.3.1) Previous publications concerning the same contract | No <input type="checkbox"/> |
| IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date from 07/03/2022 until 14/03/2022 Payable documents No <input type="checkbox"/> | |
| IV.3.3) Time limit for receipt of tender: date 04/04/2022 time 14:00 place Office of Mother Teresa Society Pristina | |
| IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tender <input type="checkbox"/> no | |
| IV.3.5) Is tender security needed: | No <input type="checkbox"/> |
| IV.3.6) Tender validity period: date: 04/04/2022 days 30 or months 1-one | |
| IV.3.7) Tender opening meeting: date 04/04/2022 time 14:30 place MTS Office Pristina | |

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in English.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "Anila & Melisa" SH.P.K. me pronar Merita Krasniqi, Vushtrri ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811490961 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Anila & Melisa" D.O.O. Merita Krasniqi, Vushtrri donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811490961 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Anila & Melisa" L.L.C. Merita Krasniqi, Vushtrri has come to the decision to quit its business: 811490961 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

ZBRITJE

MALLI

DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Auto shkolla "Trimi" në Gjilan njofton se bënë zbritje prej 35% për regjistrimin e kandidatëve të rinjë për nder të festave të muajit Mars, nga data 1mars deri më 31 mars 2022.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

